



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/173
Datë: 16.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Faza e Dytë.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/173
Datë: 16.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 6. të Rregullores Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet lista e pozitave për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës, në bazë të të gjeturave të Raportit të Komisionit për Kushte Specifike të Punës të datës 7 nëntor 2023.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucionet e tjera përkatëse për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është lista e bashkëngjitur me pozitat për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

Komisioni për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës

Data: 07/11/2023

RAPORTI I KOMISIONIT

Komisioni për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës (më tutje: Komisioni), është themeluar me vendimin Nr.02/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Komisionit i është dhënë mandati për përpilimin e raportit përfundimtar me listën e pozitave të rekomanduara për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës, në përputhje me nenin 6 dhe neni 7 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik (më tutje: Rregullorja), si dhe vlerën indicative për secilën pozitë.

Komisioni fillimisht ka përgatitur një Qarkore, me informatat dhe shpjegimet e nevojshme, e cila ju është përcjell Zyrtarëve Kryesorë Administrativ të Ministrive si dhe Kryetarëve të Komunave. Së bashku me Qarkoren u është dërguar edhe një formular në Excel, në të cilin institucioneve u është kërkuar t'i vendosin kërkesat e tyre. Komisioni thekson se secili institucion mban përgjegjësi për saktësinë e informatave të dërguara.

Kërkesa u është dërguar institucioneve me 24 shkurt 2023, kurse afati për dërgimin e kërkesave ka qenë deri më 1 mars 2023. Një numër i institucioneve kanë kërkuar afat shtesë, kërkesa të cilat Komisioni i ka mirëkuptuar.

Mandati i Komisionit është shumë specifik, ashtu siç janë edhe kriteret për klasifikimin e pozitave që potencialisht mund të jenë përfitues të shtesës për kushte specifike të punës. Për qëllime të mandatit të Komisionit, Rregullorja e lartcekur specifikon se kategoritë të cilat mund të përfitojnë shtesë mujore për kushte specifike të punës janë kategoria e pozitave që janë të ekspozuara ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kushtet specifike të punës ua rrezikojnë në mënyrë të shtuar jetën. Këto kategori të pozitave duhet t'i plotësojnë dy kriteret e parapara në paragrafët 2.1 dhe 2.2 të nenit 6 të Rregullores:

2.1.hetimi në teren, ku për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës;

2.2.kryerja e detyrave në operacione të rrezikshme, të cilët për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës.

Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e pranuar duke i klasifikuar në: kërkesa që bien nën kompetencën e Komisionit, kërkesa që nuk bien nën kompetencën e Komisionit pasi që u referohen shtesave të tjera të parapara me legjislacionin në fuqi, si dhe kërkesat për informacione plotësuese apo afat shtesë.

Institucionet të cilat kanë paraqitur kërkesa për lloje tjera të shtesave, për të cilat Komisioni nuk ka mandat t'i shqyrtojë, janë njoftuar me kohë përmes emailit nga Komisioni se këto kërkesa Komisioni nuk ka mandat t'i shqyrtojë.

Kërkesave të institucioneve për afat shtesë, Komisioni u është përgjigjur duke i njoftuar se çdo vonesë në dërgimin e kërkesave të tyre, në këtë fazë do të ndikojë edhe në përfshirjen apo jo në listën me pozitat e rekomanduara për shtesën për kushte specifike të punës.

Për kategoritë e pozitave për të cilat institucionet kanë propozuar që të kualifikohen si përfitues të shtesës për kushte specifike të punës, e të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara Rregullores (QRK) Nr. 08/2023, Komisioni u ka dërguar përgjigje përmes emailit duke i njoftuar se të njëjtat nuk janë rekomanduar si pozita që ju takon e drejta për shtesë për kushte specifike të punës.

Kërkesat e paraqitura pranë Komisionit kanë përfshirë emërtimin e pozitës, numrin e zyrtarëve në atë pozitë, përshkrimin e vendit të punës si dhe arsyetimin mbi rrezikshmërinë në vend të punës. Bazuar në përshkrimin e pozitës dhe arsyetimin mbi rrezikshmërinë, Komisioni për secilën pozitë ka vlerësuar nëse pozita i përmbush apo nuk i përmbush kriteret e parapara në nenin 6 dhe nenin 7 të Rregullores.

Pas vlerësimi të kërkesave nën mandatin e Komisionit, në këtë fazë është hartuar lista finale me kategoritë e pozitave dhe numrin e pozitave për të cilat Komisioni rekomandon se ju takon e drejta për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës, pasi që të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara në nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik. Lista me pozitat e rekomanduara për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës mund të përditësohet vazhdimisht, përmes këtij Komisioni dhe miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komisioni, duke u bazuar në vlerësimet e bëra dhe kufizimet buxhetore, ka propozuar shtatë nivele të shtesës për kushte specifike të punës, duke filluar nga Niveli I si më i ulëti e deri tek Niveli VII si më i larti:

Niveli i shtesës	Vlera e shtesës në Euro
Niveli I	45
Niveli II	50
Niveli III	60
Niveli IV	75
Niveli V	100
Niveli VI	120
Niveli VII	150

Me datë 7 nëntor 2023, Komisioni për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës, ka miratuar dhe dërguar raportin e punës së Komisionit tek Qeveria e Republikës së Kosovës me listën e pozitave dhe institucioneve që në këtë fazë rekomandohen për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës.

Më poshtë gjendet lista e plotë me pozitat dhe vlerat e rekomanduar si shtesë për kushte specifike të punës:

Institucioni	Njësia organizative	Persona	Shtesa	Trusti 5%/për pagë	Kostoja e shtesës/për muaj	Kostoja e trustit/vit	Kostoja Vjetore
Policia e Kosovës/MPB	Personeli në menaxhimin e operacioneve	350	45 €	2.25 €	15,750.00 €	9,450.00 €	198,450.00 €
Policia e Kosovës/MPB	Sigurimi i objekteve	615	50 €	2.5 €	30,750.00 €	18,450.00 €	387,450.00 €
Policia e Kosovës/MPB	Ekipet reaguese, patrullat e rendit	3412	60 €	3 €	204,720.00 €	122,832.00 €	2,579,472.00 €
Policia e Kosovës/MPB	Hetuesia	1467	75 €	3.75 €	110,025.00 €	66,015.00 €	1,386,315.00 €
Policia e Kosovës/MPB	Patrullat kufitare, NJRSH	1383	100 €	5 €	138,300.00 €	82,980.00 €	1,742,580.00 €
Policia e Kosovës/MPB	NJSO, K9, EODD	358	120 €	6 €	42,960.00 €	25,776.00 €	541,296.00 €
Policia e Kosovës/MPB	NJSI, NJNSH, NJMA	406	150 €	7.5 €	60,900.00 €	36,540.00 €	767,340.00 €
Policia e Kosovës/MPB	TOTALI	7991			603,405.00 €	362,043.00 €	7,602,903.00 €

Komisioni për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës:

Drilon Osmani, Kryetar i Komisionit

Albert Avdiu, Anëtar

Dodona Gashi, Anëtare



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/173
Datë: 16.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin 05/L-009, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 09/67 të datës 9 mars 2022

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 09/67 i datës 9 mars 2022 për emërimin e Bordit të Drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidromorava, Sh. A. Gjilan, si në vijim:
 - 1.1. Emërohet kryesuese e bordit znj. Filloreta Gashi-Sadiku, ndërsa z. Habil Zeqiri, emërohet si anëtar i bordit të lartcekur.
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 09/67 të datës 9 mars 2022.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/173
Datë: 16.11.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme ish shoqërore P. Sh IKG "Ballkan" Njësia Damper, (ish Kampi "Casablanka"), për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, parcela kadastrale Nr.2307-2, Zona Kadastrale Suharekë, Komuna Suharekë, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi është Raporti i vlerësimit për sipërfaqen e tokës i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabela e bashkëngjitur këtij Vendimi në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për tokën për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe 1 (një) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjislacionit në fuqi.

8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Agjencia Kadastrale e Kosovës është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/173
Datë: 16.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6, 7, 8 paragrafi 3, dhe nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-244 për Rezervat Shtetërore të Mallrave, nenit 5 paragrafi 1.3, nenit 6, nenit 8 paragrafi 1.2 dhe nenit 9 paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi vjetor 2023 për Rezervat Shtetërore të Mallrave.
2. Obligohet Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij Vendimi në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe Ligjin vjetor të Buxhetit.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/173

Datë: 16.11.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Rregullores Nr.12/2012 për Procedurat e Blerjes dhe Marrjes me Qira të Objektivit për Misionet Diplommatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për fillimin e procedurave për blerjen e objektivit për nevoja të Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës, në Strasburg/Republika e Francës.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe institucionet tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë